

09/ZDP/VE/2024
Datë: 24 prill 2024

Në mbështetje të neneve 15.1 (a), 20.1, 21.2, 35, dhe 36 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Marrëveshjes për Shërbime të Rregullta Ajrore ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit Federal të Zvicrës, të datës 30 Nëntor 2010 (më tutje Marrëveshja) dhe Memorandumit të Mirëkuptimit për Marrëveshje për Shërbime Ajrore, të datës 29 Prill 2009 në mes të autoriteteve aeronautike të Republikës së Kosovës dhe Zvicrës (më tutje Memorandumi),

Duke vepruar në përputhje me Vendimin nr. 05/ZDP/VE/2024, të dt. 11 mars 2024, si dhe konstatimin dhe rekomandimin e dhënë nga Grupi Punues i caktuar përmes Vendimit nr. 08/ZDP/VE/2024 të dt. 04 prill 2024, për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës (më tutje AAC),

Me qëllim të mbrojtjes të interesit publik dhe atij shtetëror, si dhe me synim të sigurimit të shërbimeve të mira me çmime konkurrencte për udhëtarët,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil nxjerr këtë:

VENDIM

- EMËROHET/DEZIGNOHET** operatori ajror "GP Aviation" Ltd., me COA nr. BG65 dhe me Certifikatë të Regjistrimit të degës në Kosovë me numër 811882217, të ushtror të drejta të trafikut ajror në përputhje me Marrëveshjen dhe Memorandumin, për në dhe nga Konfederata e Zvicrës, për periudhë tre (3) vjeçar, nga dita kur fillon ofrimin e shërbimeve të rregullta ajrore.
- Obligohet operatori ajror nga pika 1 e këtij Vendimi që gjatë kohës së ofrimit të shërbimeve ajrore t'iu përmbahet me përpikëri kriterëve të parapara në Vendimin nr. 05/ZDP/VE/2024 dhe detyrimeve të zotuara, përmes deklaratave të dorëzuara në AAC më datën 25 mars 2024 dhe sqarimeve shtesë të dorëzuara më 19 prill 2024.
- Obligohet operatori ajror nga pika 1 e këtij Vendimi që më së largu deri më 01 maj 2024 të dorëzoj në AAC garancinë bankare në emër të AAC-së në vlerë prej njëqind mijë (100,000) eurove, që mund të ekzekutohet në rast të mos-përbushjes së detyrimeve.
- Obligohet operatori ajror nga pika 1 që më së largu deri më 01 qershor 2024, të filloj shërbimet e rregullta ajrore vajtje-ardhje nga Prishtina për në Cyrih, Gjenevë dhe Bazel.



5. AAC ka të drejtë të vazhdoj afatin e dezignimit të përcaktuar në pikën 1. të këtij Vendimi për një periudhë tjetër kohore në rast të vlerësimeve pozitive të përmbushjes së kritereve, në përputhje me Vendimin nr. 05/ZDP/VE/2024 dhe detyrimet e zotuar.
6. AAC ka të drejtë të revokoj këtë dezignim para përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 1. të këtij Vendimi në rast të fillimit të operimit të një kompanie ajrore të Kosovës, ose në rast të mos-përmbushjes së kritereve të specifikuar me Vendimin nr. 05/ZDP/VE/2024 dhe detyrimeve të zotuar.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Me qëllim që të sigurohet zhvillimi i një konkurrence të mirëfilltë, ofrimit të shërbimeve të mira me çmime konkurrense për udhëtarët në tregun e shërbimeve ajrore mes Kosovës – Zvicrës, dhe me qëllim të mbrojtjes së interesit publik dhe atij shtetëror, AAC kishte vendosur përmes Vendimit nr. 05/ZDP/VE/2024 të dt. 11 mars 2024, të shpallë Thirrjen Publike për operatorët ajror të cilët mund të ofrojnë plane fluturimi dhe kapacitete me orar të programuar fluturimesh për të fituar të drejtën e fluturimit përmes emërimit/dezignimit në destinacionet në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe anasjelltas. Kriteret për t'u autorizuar si operator ajror për ushtrim të të drejtave të theksuara më lartë, ishin paraparë në Aneksin e Vendimit nr. 05/ZDP/VE/2024. Thirrja publike është mbajtur e hapur nga data 11 mars 2024 deri më 25 mars 2024, ku operatorët e interesuar kanë mundur të dorëzojnë shprehjen e interesit të tyre në AAC.

Gjatë kësaj periudhe, AAC ka pranuar shprehjen e interesit nga operatori ajror “GP Aviation” Ltd, i cili ka shprehur interesin e tij për të operuar fluturime të rregullta me orar të caktuar përmes destinacionit nga Republika e Kosovës për në Konfederatën e Zvicrës dhe anasjelltas, si operator i designuar nga Republika e Kosovës.

Me datën 04 prill 2024 Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së përmes Vendimit nr. 08/ZDP/VE/2024 ka caktuar Grupin Punues për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar në AAC, bazuar në kriteret e shpallura përmes Vendimit nr. 05/ZDP/VE/2024 të dt. 11 mars 2024.

Grupi Punues pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranuar nga “GP Aviation” Ltd., më datën 17 prill 2024, si dhe pas sqarimeve të marra më datën 19 prill 2024, ka konstatuar që aplikuesi ka përmbushur kriteret dhe si rrjedhojë ka rekomanduar Drejtorin e Përgjithshëm për të vepruar si në dispozitiv të këtij Vendimi.

AAC do të monitoroj në vazhdimësi të gjitha detyrimet dhe zotimet që operatori ajror “GP Aviation” Ltd. i ka bërë përmes deklaratave të dorëzuara gjatë aplikimit në këtë proces.

Dezignimi mund të revokohet në rast të fillimit të operimit të një kompanie ajrore të regjistruar në Kosovë si dhe në rast të mos-përmbushjes së kritereve të Vendimit nr. 05/VE/ZDP/2024, dhe detyrimeve të zotuar, para përfundimit të afatit tre (3) vjeçar.

Duke marrë parasysh nenet 15.1 (a), 20.1, 21.2, 35, dhe 36 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, i ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenin 24 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Marrëveshjen bilaterale për shërbime për transportin ajror në mes Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës, Memorandumin e Mirëkuptimit për marrëveshje për shërbime ajrore, në mes të autoriteteve aeronautike të Republikës së Kosovës dhe Zvicrës, Vendimin nr. 05/ZDP/VE/2024 dhe Rekomandimin e Grupit Punues të caktuar për shqyrtimin e dokumentacionit të pranuar në AAC, Drejtori i përgjithshëm ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të ngrit kontest administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi.


Burim Dinarama
UD. Drejtor i Përgjithshëm



Vendimi i dërgohet:

- “GP Aviation” Ltd.
- Ministrit të MMPHI;
- Zyrës Federale të Aviacionit Civil të Zvicrës (FOCA); dhe
- Arkivit të AAC-së.